



## KONTRATA

Numri i kontratës: 616-21-7782-2-1-1/C891

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**N.SH. 'RAKETA**, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), me adresë ,Norbert Jokl 23 Prishtinë me numër te regjistrimit te biznesit 810470394, e përsaqësuar nga Sabri Azemi, ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

**Mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore ne Shkollat dhe institucioneve tjera Komunale**

Nr <sup>1</sup> i prokurimit	616-21-7782-2-1-1
Nr i brendshëm	616 21 150 211

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:  
**Mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore ne Shkollat dhe institucioneve tjera Komunale**

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: [ 160.000,00 ] €; [*njeqind e gjashtdhjet mijë euro*] Euro.

2.2 Çmimi i përmendor në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

**Neni 3 Rendi i përparrësise i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshtësia në njoftim i tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Drejtori I Prokurimit	Zyrtari Kryesor Administrativ		
Emri: <b>Nexhami Mekolli</b>	Përparim Rama	Emri:	<i>Sahmi Arifi</i>
Pozita: <b>Udhëheqës i Prokurimit</b>	Kryetar I Komunës	Pozita:	<i>Drejtor</i>
Nënsh.		Nënsh.	
Data:	03.08.2022	Data:	
Vula:		Vula:	

## **PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Përkusizimet**

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përsaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejara, për të cilin çdo pjese e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkuption Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palë" nënkuption të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkuption autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkuption Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkuption Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### **Neni 3 Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përsitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjeter i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjeter financiar.

### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te oferës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga

Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përm bushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshire në çmimin e kontratës.

#### Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjeter të mëvonshme si mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njostimit të dhënes së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse ushton brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

#### Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyet:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e desinuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njostoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhë, përvçese kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njostimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forca madhore që shkaktohet pas datës së njostimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forca madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mylljet e objektit ose çrrëgullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vëlfërima, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjeter e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dëshimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dëshimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palen tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim. Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdlerisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjetë të tillë alternative përvëç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë konratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dëshitim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt konratën apo nënkonratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u myllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykata, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjyktimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur sajtor për sjellje të rendë të keqë jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjyktimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përvëç nëse këto modifikime registrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në konratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njostimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëherëshëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjogluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përsaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhën Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston

ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpert kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të asfatit të fundit;
- b. vazhdimi i nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafshët kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përejt fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta ristrojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informata e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të janë bashkërisht dhe vazhdimi i obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkësës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefekishëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkalojnë dhe aksidenti janë thelbisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

#### Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 13 Dëmet e likuiduara

**13.1** Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në dytirimet e Ofruesit të Shërbimeve.

**13.2** Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

#### **Neni 14              Siguria e ekzekutimit**

**14.1** Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

**14.2** Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

**14.3** Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

#### **Neni 15              Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve**

**15.1** Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe pëmbulim, siç do të specifikojet në KVK.

**15.2** Ofruesi i Shërbimeve, me kërkeshë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### **Neni 16              Parimet e përgjithshme të pagesës**

**16.1** Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do te specifikojet ne KVK.

**16.2** Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikasi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërcesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

**16.3** Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkasat thelbësore.

**16.4** Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

**16.5** Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3. Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

**16.6** Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### **Neni 17              Kontrolli i kualitetit**

**17.1** Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur.

Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç pëershruhet në nenin 13.1.

#### Neni 19 Konsekuenca e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetër me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e shet të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkuesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkuesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkuesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes duke e lajmëruar tjetër.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të

shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një pale e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

### **PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	1>Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 01.10.2022
	6.4	Data e Përfundimit është 01.10.2023
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është Prishtinë
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit <i>do te caktohet nga ZKA</i> .
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 16,000 ne afat prej 13 muajve
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	15.1	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsy, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përpunhje me dispozitat e kontratës sipas kërkësave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjë në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impanteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi.

		<p>kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>(ii) e personave të tjera: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Pagesës	16.1	<i>Pagesat do te behen ne situacione per cdo muaj me konstatim nga menaxheri i kontrates</i>
Kontrolli i kualitetit	17.1	Periudha Garantuese e Defekteve është 3 vjet
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p><b>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi</b></p>

**MIREMBAJTJA E NGROHJES QENDRORE NE SHKOLLA DHE INSTITUCIONE TJERA KOMUNALE**

Kategoritë	Nr.	Emërtimi i paísjeve	Njesia	Sasia	Çmimi njesi me TVSH
Kateg. I-rë		Kategoria e I-rë			
<b>Furnizimi dhe montimi me Radiatoret panel Tip22/H600-</b>					
1					
400			cope	1	24.60
600			cope	1	36.90
800			cope	1	48.96
1000			cope	1	61.20
1200			cope	1	91.80
1400			cope	1	107.10
1600			cope	1	122.40
1800			cope	1	125.00
2000			cope	1	130.05
2200			cope	1	135.00
<b>Furnizimi dhe montimi me Radiatoret panel Tip22/H900-</b>					
2					
600			cope	1	20.00
800			cope	1	23.00
1000			cope	1	26.00
1200			cope	1	29.00
1400			cope	1	33.00
1600			cope	1	37.00
1800			cope	1	39.00
2000			cope	1	42.00
2200			cope	1	44.00
2400			cope	1	46.00
<b>Furnizimi dhe montimi me Radiatoret panel Tip33/H300</b>					
3					
600			cope	1	15.00
800			cope	1	20.00
1000			cope	1	25.00
1200			cope	1	28.00
1400			cope	1	34.00
1600			cope	1	36.00
1800			cope	1	40.00
2000			cope	1	44.00
4 Demontimi i radiatoreve te vjetër			cope	1	50.00
5 F.M.Mbajtse te radiatorve H600			cope	1	15.00
6 F.M.Mbajtse te radiatoreve H900			cope	1	2.00
7 F.M.Mbajtse te radiatoreve H300			cope	1	2.00
8 F.M.Mbajtse te dyshemese per radiat.			cope	1	5.00
9 F.M.Valvula te radiatorve 1/2 te eperm			cope	1	35.00
10 F.M.Valvula te radiatorve 1/2 te poshtem			cope	1	35.00
11 F.M.Valvula te radiatorve 3/4 te eperm			cope	1	10.00
12 F.M.Valvula te radiatorve 3/4 te poshtem			cope	1	10.00
13 F.M.Termokoke per valvule te njegyporit			cope	1	5.00
14 F.M.Valvula e sistemit njegypore			cope	1	5.00
15 F.M.Valvula mbushje zbrasje 1/2			cope	1	10.00
16 F.M.Kolektore 1"/ 2x1/2"			cope	1	2.00
17 F.M.Kolektore 1"/ 3x1/2"			cope	1	2.50
18 F.M.Kolektore 1"/ 4x1/2"			cope	1	2.70
19 F.M.Kolektore 1"/ 5x1/2"			cope	1	2.80
<b>Furnizimi dhe montimi i Gypve CU</b>					
			CU 15	cope	1
					3.48
<b>Kategoria e I-re peshuar sipas rendesise 30%</b>					

20	CU 18	cope	1	4.07
	CU 22	cope	1	5.06
	CU 28	cope	1	8.00
	CU 35	cope	1	9.00
21	Furnizimi dhe montimi i fitingut të gypave 50% te pozicionit 20	50%	1	14.81
22	F.M.Valvula jo kthyesë	cope	1	
	1/2"	cope	1	3.00
	3/4"	cope	1	3.50
	1"	cope	1	3.70
	5/4"	cope	1	4.00
	6/4"	cope	1	4.80
	2"	cope	1	5.80
23	F.M.Valvula sferike me holonder:			
	1/2"	cope	1	8.00
	3/4"	cope	1	10.00
	1"	cope	1	15.00
	5/4"	cope	1	20.00
24	F.M.Manometer 10 bar	cope	1	2.00
25	F.M.Termomanometer	cope	1	25.00
26	F.m.Valvula automatik per qajrosje	cope	1	30.00
27	Furnizimi dhe montimi me Valvula siguruese			
	1/2"	cope	1	4.00
	3/4"	cope	1	6.00
	1"	cope	1	10.00
	5/4"	cope	1	15.00
	6/4"	cope	1	20.00
28	Izolim i gypave me llamarin dhe lesh mineral			
	80	m2	1	5.00
	100	m2	1	6.00
	120	m2	1	7.00
	140	m2	1	8.00
	160	m2	1	30.00
	180	m2	1	9.00
	200	m2	1	30.00
	250	m2	1	10.00
29	Furnizimi dhe lyerja me Minium-antkorizon dhe ngjyrë	L	1	20.00
TOTAL Kategoria I				2,017.23
Kateg. II-te	Kategoria e II-të			
30	Furnizimi dhe montimi i mbrojtjes bimetallike per flakehedhes	cope	1	12.00
31	Furnizimi dhe montimi i mbrojtjes bimetallike per pompe	cope	1	40.00
32	Furnizimi dhe montimi i pompave riqarkulluese			
	GHN 25-60F	cope	1	35.00
	GHN 32-60F	cope	1	60.00
	GHN 32-80F	cope	1	80.00
	GHN 40-70F	cope	1	250.00
	GHN 40-120F	cope	1	370.00
	GHN 50-70F	cope	1	420.00
	GHN 50-120F	cope	1	460.00
	GHN 65-70F	cope	1	480.00
	GHN 65-120F	cope	1	539.00
	GHN 80-120F	cope	1	620.00
	GHN 100-1630	cope	1	680.00
Kategoria e II-te peshuar sipas rendesise	Furnizimi dhe montimi i Gjunte antivibruese nga goma me filangje			
	DN-25	cope	1	2.00

10%

		DN-32	cope	1	3.00
		DN-40	cope	1	4.00
		DN-50	cope	1	5.00
		DN-65	cope	1	6.00
		DN-80	cope	1	7.00
		DN-100	cope	1	8.00
		DN-125	cope	1	9.00
	33	Intervenimet elektrike ne kaldatore	orë	1	100.00
		Furnizimi dhe montimi i eneve ekspanduese			
		80L	cope	1	30.00
		100L	cope	1	35.00
		140L	cope	1	40.00
	35	200L	cope	1	45.00
		250L	cope	1	220.00
		300L	cope	1	80.00
		400L	cope	1	90.00
		500L	cope	1	100.00
		600L	cope	1	110.00
		Furnizimi dhe montimi i elektro-valvulave perzise			
		DN-25	cope	1	10.00
		DN-32	cope	1	12.00
	36	DN-40	cope	1	14.00
		DN-50	cope	1	16.00
		DN-65	cope	1	18.00
		DN-80	cope	1	20.00
		DN-100	cope	1	22.00
		DN-125	cope	1	24.00
		Furnizimi dhe montimi i valvolave me flanshe dhe kunder flanshe			
		DN-25	cope	1	6.00
		DN-32	cope	1	10.00
	37	DN-40	cope	1	40.00
		DN-50	cope	1	50.00
		DN-65	cope	1	60.00
		DN-80	cope	1	80.00
		DN-100	cope	1	100.00
		DN-125	cope	1	120.00
		Furnizimi dhe montimi i mledhesve të papastertise			
		DN 100	cope	1	20.00
	38	DN 65	cope	1	18.00
		DN 50	cope	1	16.00
		DN 40	cope	1	15.00
		DN 32	cope	1	5.00
		DN 25	cope	1	3.00
		TOTAL Kategoria II			5,619.00
Kateg. III-te		Kategoria e III-të			
		Furnizimi me Flakehedhes nafte-flakadan			
		47-105 kW	cope	1	50.00
		60-130 kW	cope	1	70.00
	39	86-237 kW	cope	1	120.00
		142-296 kW	cope	1	210.00
		273-415 kW	cope	1	260.00
		290-540 kW	cope	1	390.00
		415-711 kW	cope	1	450.00
		460-932 kW	cope	1	480.00
	40	Servisimi i Flakehedhesit(te naftes)	cope	1	250.00
		Furnizimi me Flakehedhes peleti (flakadan) me depozit peleti dhe elevatore			

Kategoria e  
III-te peshuar  
sipas  
rendesise  
10%

	25-50 kw	cope	1	210.00
	50-100 kw	cope	1	240.00
	100-150 kw	cope	1	260.00
	150-200 kw	cope	1	280.00
	200-250 kw	cope	1	290.00
	250-300 kw	cope	1	310.00
	300-350 kw	cope	1	320.00
42	Servisimi i Flakehedhesit(të peletit)	cope	1	250.00
43	Furnizimi dhe mbushja me glykol mono polypropylene EKO -50°C me certifikatat ISO 9001 dhe ISO 14001	kg	1	5.00
	TOTAL kategoria III			4,445.00

Kateg. IV-të	Kategoria e IV-te			
	Servisimi i Kaldajave me lende djegese pelet			
	80KW	cope	1	5.00
	90KW	cope	1	5.00
	100KW	cope	1	5.00
	150KW	cope	1	5.00
	200KW	cope	1	5.00
	250KW	cope	1	5.00
	300KW	cope	1	5.00
	350KW	cope	1	5.00
	400KW	cope	1	5.00
	450KW	cope	1	5.00
	500KW	cope	1	5.00
	Servisim i Kaldajave me nafte me kapacitet			
	80KW	cope	1	5.00
	90KW	cope	1	5.00
	100KW	cope	1	5.00
	150KW	cope	1	5.00
	200KW	cope	1	5.00
	250KW	cope	1	5.00
	300KW	cope	1	5.00
	350KW	cope	1	5.00
	400KW	cope	1	5.00
	450KW	cope	1	5.00
	500KW	cope	1	5.00
46	Pastrimi i rezervuarëve të naftës	cope	1	20.00
47	Shqyrtimi i sistemit dhe Ishuarja ne punë	dité	1	200.00
	TOTAL Kategoria IV			330.00

Kateg. V-te	Kategoria e V-të			
	Furnizimi dhe montimi i gypave te çelikut me tegel			
	DN-15	m'	1	18.00
	DN-20	m'	1	20.00
	DN-25	m'	1	22.00
	DN-32	m'	1	24.00
	DN-40	m'	1	26.00
	DN-50	m'	1	28.00
	DN-65	m'	1	30.00
	DN-80	m'	1	32.00
	DN-100	m'	1	32.50
48	Furnizimi dhe montimi i fittingut të gypave 50% te pozicionit 48	50%	1	116.25
49	Furnizimi dhe montimi Gyp CU PVC ø15x1mm	m'	1	15.00
50	Furnizimi dhe montimi me Lidhse të kolektorëve për CU	cope	1	20.00
	TOTAL Kategoria V			383.75
Kateg. VI-te	Kategoria e VI-të			
	52 Shkrirja e akullit në sistemin gypor të ngrohjes	meter	1	15.00

Kategoria e VI-te peshuar sipas rendesise  
5%

53	Punë me saldim	ore	1	150.00
54	Fitingu 50% i pozicionit 53	50%	1	75.00
	Furnizimi dhe montimi i gypave të çelikut te zingtuar			
	1/2	m'	1	3.00
	3/4	m'	1	5.00
	1"	m'	1	7.00
	5/4	m'	1	10.00
	6/4	m'	1	12.00
	2"	m'	1	14.00
56	Fiting 50% nga pozicioni e 55	50%	1	25.50
57	Thyreje betoni me kompresor per sanimin e rrjedhjeve	orë	1	60.00
58	Hapja e kanalit për shtrirjen e gypave	m	1	80.00
59	Furnizimi dhe Montimi i plakave, montimi i parketit, shtruarja me beton	m <sup>2</sup>	1	80.00
	Furnizimi dhe montimi i Fan-Coilava Qn/Qf			
	3.6 /1.5 kW	cope	1	360.00
	5.8 /2.5 kW	cope	1	470.00
	7.8 /3.5 kW	cope	1	480.00
	10.1 /4.6 kW	cope	1	210.00
	12.9/5.7 kW	cope	1	215.00
	15.4/6.6 kW	cope	1	220.00
	17.6/7.5 kW	cope	1	225.00
	23.6/11.1 kW	cope	1	230.00
61	Servisimi dhe mirembajtja e fancoilave	cope	1	50.00
62	F.M.Bojler elektrik 80 litra me pjese perçellse	cope	1	35.00
63	F.M.Bojler elektrik 10 litra me pjese perçellse	cope	1	10.00
64	F.M.Gyp PET sistem gjakomini uje I nxhehte1/2	m'	1	5.00
65	F.M.Gyp PET sistem gjakomini uje I ftohte1/2	m'	1	5.00
66	Furnizimi dhe montimi me Gyp PET sistem gjakomini 3/4	m'	1	6.00
67	Furnizimi dhe montimi me Kolektore uji Ø3/4x1/2	vrima	1	10.00
68	F.M Koka muri per sistem gjakomini	cope	1	6.00
69	Ngyrosja e radiatorëve ekzistues	cope	1	20.00
70	F. M. I kaloriferave 25 kW	cope	1	550.00
71	F.M. I rezervuarit ditor të naftës 1000Litra në kaldatore	cope	1	30.00
72	F.M. I pompës për naftë për têrheqjen e naftes deri te	cope	1	50.00
73	Furnizimi dhe Montimi i stufës 500 kW (lëndë djegëse naftë)	cope	1	800.00
74	Demolimi i kaldajes ekzistuese dhe bartja në deponi	paush.	1	100.00
75	Furnizimi dhe montimi i Ventilatoreve			
	TD 250 m <sup>3</sup> /h	cope	1	180.00
	TD 780 m <sup>3</sup> /h	cope	1	220.00
	TD 1600 m <sup>3</sup> /h	cope	1	260.00
76	Ventilator aksial 2500 m <sup>3</sup> /h	cope	1	150.00
77	PV-Ventila Ø125	cope	1	15.00
78	Gypa fleksibil Al Ø125	m	1	15.00
79	Grilla me rregullim			
	325x225	cope	1	20.00
	525x225	cope	1	25.00
80	Kanale te ventilimit nga llamarina e zinguar	kg	1	15.00
81	Pjese fazonike, per kanale te ventilimit, material i imet per fiksime 30% nga poz. 80	%	0.3	4.50
	Ndertimi i oxhakeve me dimensione sipas standardeve per oxhak per ngrohje qendrore me dimensione(pershire deren per pastrim, mbulesen per mbrojtje nga shiu, izolimin e tyre) nga materiali i çelikut			
82	Ø250	m	1	120.00
	Ø350	m	1	160.00
	Ø450	m	1	180.00

	Ø550	m	1	220.00
--	------	---	---	--------

TOTAL Kategoria VI

6,208.00

	çmimi total	çmimi total i peshuar	
A - Kategoria I	€ 2,017.23	€ 605.17	30%
B - Kategoria II	€ 5,619.00	€ 561.90	10%
C - Kategoria III	€ 4,445.00	€ 444.50	10%
D - Kategoria IV	€ 330.00	€ 99.00	30%
E - Kategoria V	€ 383.75	€ 57.56	15%
F - Kategoria VI	€ 6,208.00	€ 310.40	5%

Çmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do te vleresohen ne baze te kesaj vlore). Kjo ështe vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjate hapjes publike.

€ 2,078.53

